



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 463/2 Prot.

Tiranë, më 06/09/2013

Lënda: Rekomandohet marrja e masave për mbulimin e nevojave të shërbimit me mjekë specialistë si dhe përshtatshmërinë dhe aksesueshmërinë e spitalit Përmet për personat me aftësi të kufizuara.

Drejtuar: **Z. Halim KOSOVA**
Ministër i Shëndetësisë
Blv: “Bajram Curri”
TIRANË

Inderuar Z. Kosova,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në zbatim të Ligjit 10221, datë 10.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, dhe në funksion të përmbushjes së detyrës për mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminim ka shqyrtuar ankesën e shtetasit L.Sh, banor i qytetit të Përmetit. Në ankesën e tij shtetasi L.Sh i cili është person me aftësi të kufizuara dhe trajtohet si invalid paraplegjik i Grupit I, pretendon se për shkak të gjendjes së tij shëndetësore i duhet të udhëtojë për në spitalin rajonal të qytetit Gjirokastër për tu vizituar, pasi në spitalin bashkiak të Përmetit mungojnë mjekët specialistë. Nga ana tjetër dhe mjediset e spitalit Përmet nuk janë të përshtatura dhe të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara, pasi hyrja për në mjediset e brendshme të spitalit është e pa përshtatur dhe mosfunkcionimi i ashensorit nuk lejon shfrytëzimin e mjediseve të katit të dytë e më sipër të këtij spitali.

Sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke kryer inspektimin në spitalin Përmet.

Bazuar në inspektimin e kryer në datë 11.07.2013 u konstatua se në spitalin Përmet nuk ofroheshin shërbime të mjekëve në specialitetet: reanimacion, dermatolog dhe infekzionist. Shërbimet e mjekëve kardiolog dhe okulist mbuloheshin në mënyrë të pjesshme me mjekë nga spitali Tepelenë, si dhe për specialitetet e mjekut kirurg, obstetër-gjinekolog, ORL dhe endokrinolog, shërbimi mbulohesh nga mjekë që kishin mbushur moshën e daljes në pension të cilët me shkresat nr. 3608/1, datë 14.06.2012

dhe nr. 1530/1, datë 26.03.2013 ishin miratuar nga Ministria e Shëndetësisë, për shtyrje të afatit të daljes në pension.

Gjatë inspektimit të datës 11.07.2013 nga ana e inspektorëve u konstatua se hyrja për në spital dhe tek dhomat e mjekëve nuk ishin të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara.

Sipas deklarimit të pacientit dhe mjekëve të spitalit, rezulton se pacienti për shkak të kushteve shëndetësore të veçanta duhet të udhëtonte një herë në tre muaj drejt spitalit rajonal Gjirokastër për vizita mjekësore më të specializuara, duke e ngarkuar atë me një barrë financiare, të vështirë për tu përballuar nga ana e tij.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatesinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionë gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatesinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër*”.

Në nenin 3, pika 7 të këtij ligji, përcaktohet se: “*Mohim i një përshtatje të arsyeshme është ajo formë diskriminimi që ndodh kurdoherë kur ka një mohim ose kundërshtim për të kryer ndryshime ose rregullime të domosdoshme e të përshtatshme që nevojiten në një rast të veçantë dhe nuk imponojnë një barrë të tepruar, me qëllim që të sigurohet gëzimi dhe ushtrimi në baza të barabarta i të drejtave dhe lirive themelore për personat me aftësi të kufizuar, ose të ndodhur në kushtet e tjera të përmendura në nenin 1 të këtij ligji*”.

Diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar, është shkak i cili gëzon mbrojtje nga ligji dhe bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me aftësinë e kufizuar.

Legislacioni i Republikës së Shqipërisë njeh të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Kështu, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë garanton të drejtat dhe liritë themelore të personave me aftësi të kufizuara, në nenin 55/1 sanksionohet se: “*Shtetasit gëzojnë në mënyrë të barabartë të drejtën për kujdes shëndetësor nga shteti*”, si dhe në Kreun V, ku parashikohen Objektivat Socialë, në nenin 59, pika 1) nënvizon se: “*Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon..... e) përkujdesjen dhe ndihmën për të moshuarit, jetimët dhe invalidët*”.

Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 108/2012 ka ratifikuar Konventën e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”, (e cila është pjesë e legjislacionit të brendshëm Shqiptar), në nenin 9, pika 1/a shkruhet: “*Heqja e barrierave, 1. Me qëllim që të bëhet e mundur që të gjithë personat me aftësi të kufizuara të jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës, shtetet palë duhet të marrin masat e duhura për të siguruar mundësimin për personat me aftësi të kufizuara, në baza të barabarta me të tjerët, në ambientet fizike, transport, informacion dhe komunikim, përfshirë dhe teknologjite dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit,*

si dhe në mjete apo shërbime të tjera të hapura apo të siguruara për publikun, si në zonat urbane dhe ato rurale. Këto masa, të cilat duhet të përfshijnë identifikimin dhe eliminimin e pengesave dhe barrierave për mundësimin, zbatohen ndër të tjera për: a) ndërtesa, rrugë, transport dhe mjete të tjera në ambiente të brendshme apo të jashtme, përfshirë shkollat, strehimin, shërbime mjekësore apo vendet e punës”.

Ofrimi i shërbimit mjekësor është thelbësor për personat me aftësi të kufizuara, prandaj përshtatja e këtyre ambienteve merr prioritet në realizimin e kushteve për të cilat ato janë krijuar.

Për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke ju referuar dhe ligjit nr. 10107, datë 30.03.2009 “Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, neni 4, pika 3, në të cilin shkruhet se: “*Ministri i Shëndetësisë drejton politikën, organizimin dhe mbikëqyrjen e sistemit të kujdesit shëndetësor*”, kërkon nga ana Juaj, që në fryshtat e respektimit të ligjit dhe të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, të vlerësoni dhe të merrni masa në drejtim të ofrimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor si dhe përshtatjes së mjediseve spitalore për personat me aftësi të kufizuara.

Mbështetur në nenin 32, pika 1/f, të Ligjit nr. 10 021, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ku parashikohet shprehimisht *kompetenca e Komisionerit për të kryer rekomandime për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin,*

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi :

REKOMANDON :

1. Ministria e Shëndetësisë të marrë masa për plotësimin me mjekë specialistë të spitalit Përmet.
2. Ministria e Shëndetësisë të marrë masa për sigurimin e transportit falas për personat me aftësi të kufizuara që kanë nevojë për shërbime të specializuar që nuk mbulohet nga Spitali Përmetit.
3. Ministria e Shëndetësisë të marrë masa për përshtatjen e mjediseve të spitalit Përmet për personat me aftësi të kufizuara.
4. Bazuar në nenin 33/11 të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” kërkojmë informimin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi brenda 30 (tridhjetë) ditëve, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin tuaj,

